



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONIT I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 174 Akti

Nr. 171 Vendimi

Tiranë, më 26.06.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari
Xhensila Pine
Roland Ilia

Kryesuese
Relatore
Anëtar

në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në datën 24 qershor 2019, ora 11:45, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Eugen Beçi**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë për Krime të Rënda, Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenet D dhe DH të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi i çështjen, duke u bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: atë pasuror, të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Eugen Beçi, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë për Krime të Rënda dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*

2. Ky subjekt i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 17.9.2018, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

3. Në zbatim të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, procesi ndaj subjektit të rivlerësimit z. Eugen Beçi, ka filluar menjëherë pasi është caktuar me short trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe është shpërndarë me short çështja konkrete.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues në datën 3.10.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuesja e trupit gjykues, komisionere Valbona Sanxhaktari. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues dhe fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Eugen Beçi.

5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (në vijim ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

6. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016; në përfundim të të cilit ka konstatuar:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *la burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

7. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me atë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, dhe në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, dhe ka konstatuar *papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Eugen Beçi.*

8. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

9. Në vijim, janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

10. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, në datën 06.06.2019, vendosi bazuar në pikën 2 të neni 4, të ligjit nr. 84/2016 përfundimin e hetimit kryesisht për dy kritere: atë të pasurisë dhe të figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Eugen Beçi, pasi provat kishin arritur nivelin e provueshmërisë vetëm për këto kritere, dhe si dhe njoftimin për t'u njohur me materialet e dosjes, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 – 40 dhe 45 – 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

11. Subjekti i rivlerësimit, z. Eugen Beçi në datën 7.6.2019 u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime, apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni.

12. Pas administrimit dhe shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Eugen Beçi, në seancë dëgjimore.

13. Subjekti i rivlerësimit, z. Eugen Beçi, u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 20.6.2019.

I. SEANCA DËGJIMORE

14. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 24.6.2019, ora 11:45, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, salla B, Tiranë, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma.

15. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit z. Eugen Beçi, u paraqit dhe u mbrojt personalisht, shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit z. Eugen Beçi, kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

16. Subjekti i rivlerësimit, z. Eugen Beçi, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, në drejtim të respektimit të afateve të përcaktuara, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

III. KONTROLLI I FIGURËS

17. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Eugen Beçi, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

18. Trupi gjykues i Komisionit konstatoi se raporti i parë i sjellë nga ky institucion referonte gabim emrin e subjektit, ndaj iu kërkua Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar rishikimi dhe saktësimi i këtij raporti.

19. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën me nr. *** prot., datë 4.4.2019, ka dërguar në Komision raportin e rishikuar për kontrollin e figurës, i deklasifikuar plotësisht me vendim nr. ***, datë 2.4.2019 të KDZH-së, me konkluzionin si më poshtë vijon:

“Në vlerësim të të dhënave mbi subjektin e rivlerësimit, z. Eugen Beçi gjykohet se: referuar parashikimeve të bëra në Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, në nenin DH “Kontrolli i figurës”, pika 4, subjekti i rivlerësimit, z. Eugen Beçi, evidentohet se ka bërë deklaram të pasaktë në plotësimin e Deklaratës për Kontrollin e Figurës, konkretisht në germës “g”, të pjesës nr. 5, “Të dhëna për sigurinë”, pasi nuk ka deklaruar revokimin e vizës amerikane si fakt i ndodhur para ditës së dorëzimit të formularit për kontrollin e figurës. Për sa më sipër, mosdeklarimi në këtë rast, e ngarkon subjektin, z. Eugen Beçi, me përgjegjësinë e fshehjes së faktit dhe me plotësimin jo me vërtetësi të deklaratës për kontrollin e figurës.

Grupi i Punës rishikon konstatimin fillestar të figurës së subjektit të rivlerësimit dhe arrin në përfundimin mbi papërshtatshmërinë e vijimit të ushtrimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit, z. Eugen Beçi.”

IV. RIVLERËSIMI I FIGURËS NGA KOMISIONI

20. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur bazuar në pikat 4 dhe 6, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016,

21. Komisioni kreu një kontroll për figurën e subjektit të rivlerësimit bazuar në dy elemente që plotësojnë njëri-tjetrin: a) elementin formal të këtij kontrolli, nëpërmjet konstatimit të plotësisë dhe besueshmërisë së deklaramit; dhe b) elementin përmbajtësor të këtij kontrolli, nëpërmjet konstatimit të ekzistencës së kontaktit të papërshtatshëm.

a) Për sa i përket elementit formal të kontrollit të figurës

22. Komisioni arsyeton se standardet e kontrollit të figurës përcaktohen nga pika 4, e nenit DH, e Aneksit të Kushtetutës dhe rrethanat që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklaramit nuk është i plotë dhe i besueshëm, sipas pikës 4 të këtij neni, janë kur subjekti përpiqet të bëjë deklaramit të pasakta.

23. Pas analizimit të raportit dhe dosjes se dërguar nga DSIK-ja, Komisioni konstatoi se Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar me shkresën me nr. *** prot., datë 4.4.2019, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, z. Eugen Beçi, nuk ka deklaruar revokimin e vizës amerikane, si fakt i ndodhur para ditës së dorëzimit të formularit për kontrollin e figurës.

24. DSIK-ja informoi Komisionin se: *“Subjekti i rivlerësimit, z. Eugen Beçi, ka dorëzuar deklaramit me nr. *** prot., në datën 27.1.2017. Në këtë regjistër është nënshkrimi i tij dhe emri mbiemri dhe nënshkrimi i punonjësit të DSIK-së”*,

24.1 DSIK-ja informoi Komisionin se subjektit të rivlerësimit, z. Eugen Beçi, i është revokuar viza amerikane në datën 26.1.2017.

25. Ky fakt nuk ishte pasqyruar nga subjekti i rivlerësimit në plotësimin e deklaramit për kontrollin e figurës, (dorëzuar në DSIK në datën 27.1.2017) konkretisht në germën “g”, të pjesës nr. 5, “Të dhëna për sigurinë”, si fakt i ndodhur para ditës së dorëzimit të deklaramit për kontrollin e figurës në DSIK nga subjekti.

26. Sa më sipër është konfirmuar edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, me shkresën nr. *** prot., datë 20.11.2018, drejtuar Komisionit, duke deklaruar si më poshtë:

*“Siç edhe ligji e kërkonte, në datën 27.1.2017 kam dorëzuar formularin nr. *** prot. të deklaramit për kontrollin e figurës në DSIK. Para datës 27.1.2017, Zyra Konsullore pranë Ambasadës Amerikane në Tiranë më njoftoi për revokimin e një vize trevjeçare që kisha marrë pranë kësaj ambassade, duke bërë dhe shënimet përkatëse.”*

27. Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe pikën 4 të nenit DH, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën për mosplotësimin me saktësi të deklaramit së kontrollit të figurës.

28. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit shpjegoi: *“... theksoj se mbi bazën e koncepteve juridike, gjuhësore dhe logjike, në asnjë rast nuk i është refuzuar hyrja jo vetëm në SHBA, por në asnjë vend tjetër anëtar apo jo anëtar i Bashkimit Europian. Për këtë mbetet i bindur bazuar në fakte, prova dhe shpjegime të këtyre koncepteve nga vetë ligjzbatuesit e shtetit për të cilin ju bëni fjalë, pra, SHBA-së.”*

29. Faktin që i ka thënë JO kësaj pyetjeje, subjekti e ka argumentuar në bindjen e tij duke iu referuar informacionit zyrtar në faqen e Ambasadës Amerikane, ku sipas ligjeve amerikane shpjegohet koncepti i vizës dhe hyrjes në një pikë kalimi kufitar të tyre.

Arsyetimi ligjor

30. Duke pasur parasysh: (i) deklaramit e subjektit të rivlerësimit në deklaramit e kontrollit të figurës “Vetting”; (ii) raportin e DSIK-së; (iii) provat shkresore dhe faktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ; (iv) shpjegimet nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit dhe në seancë dëgjimore, Komisioni arsyeton se:

30.1 Paragrafi 2, i nenit DH, i Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: *“Subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe dorëzojnë një deklaramit të detajuar për figurën e tyre, që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklaramit sipas ligjit”*.

30.2 Paragrafi 4, i nenit DH, i Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: *“Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të bëjë deklarime të pasakta, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”*.

31. Në deklaratën e plotësuar, të nënshkruar dhe të dorëzuar në DSIK për kontrollin e figurës, subjekti i rivlerësimit, z. Eugen Beçi, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, ka deklaruar se:

a) nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të NATO-s, ndërkohë që Konsullata e Shteteve të Bashkuara të Amerikës i ka revokuar

b) është i ndërgjegjshëm se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës për kontrollin e figurës mund të passjellë shkarkimin e tij nga detyra sipas ligjit.

32. Subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për të deklaruar refuzimin e hyrjes në SHBA (vend anëtar i NATO-s), në zbatim të parashikimeve ligjore të germës “g”, të pjesës nr. 5, të “shtojcës 3”, të ligjit nr. 84/2016, duke mos e pasqyruar këtë fakt të ndodhura deri në ditën e deklarimit, në përgjigjen e dhënë pyetjes, nëse gjatë 10 viteve të fundit i është refuzuar hyrja vende të BE-së/NATO-s.

33. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës, në lidhje me plotësimin në mënyrë të pasaktë të formularit të deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe fshehjen e fakteve dhe të rrethanave të ndodhura para dorëzimit të këtij formulari, sipas nenit 39, të ligjit nr. 84/2016.

b) Për sa i përket elementit përmbajtësor të këtij kontrolli

34. Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, përcaktohen në pikën 4, të nenit 38, dhe janë në rastet kur:

- i. subjekti i rivlerësimit është fotografuar, ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
- ii. subjekti i rivlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një komunikim jorastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
- iii. subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
- iv. subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
- v. subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar.

35. Në deklaratën e plotësuar, të nënshkruar dhe të dorëzuar në DSIK për kontrollin e figurës, subjekti i rivlerësimit, z. Eugen Beçi, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, ka deklaruar se ka pasur një kontakt të papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, sipas pikës 4, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016.

37. Nisur nga fakti se ky kontakt i papërshtatshëm i deklaruar nga subjekti përbënte një fakt të njohur, pasi lajmi ishte publikuar në gazetat e asaj kohe, Komisioni nuk e konsideroi deklarimin e subjektit si një rrethanë lehtësuese duke arsyetuar se ai nuk mund të fshihte një fakt të njohur publikisht. Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin DH/4, të Aneksit të Kushtetutës, iu kalua subjektit barra e provës, për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera, për të provuar të kundërtën për këtë kontakt të papërshtatshëm, deklarimi i të cilit duket se nuk ishte në kushtet e asnjërit prej parashikimeve të pikës 5, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016.

38. Subjekti i rivlerësimit, me shpjegimet e sjella Komisionit me nr. *** prot., datë 17.6.2019, shpjegoi se ky kontakt lidhet me kohën dhe rezultatet e hetimit të procedimit penal nr. *** të

vitit 2015, filluar nga Prokuroria për Krime të Rënda në datën 3.3.2015, në kohën kur ai ka qenë drejtues i kësaj prokurorie, dhe konteksti i regjistrimit dhe i bërjes publike të fotos për të cilën bëhet fjalë është i lidhur ngushtësisht me këtë hetim, tashmë të kryer.

39. Subjekti deklaroi se publikimi i lajmit ka qenë i qëllimshëm dhe se ai, kohë më vonë, ka mësuar se shtetasi F. S. ka qenë i dënuar në vitin 2008 nga Gjykata e Lartë për mbajtje të lëndëve narkotike, sipas nenit 283 të Kodit Penal, për një fakt penal të hetuar në Itali.

40. Subjekti ka shpjeguar se nuk ka pasur asnjë lidhje me çështjen penale të shtetasit F. S., nuk ka hetuar apo gjykuar asnjëherë shtetasin F. S. apo ndonjë të afërm të tij dhe, gjatë ushtrimit të detyrës, nuk është gjendur asnjëherë në konflikt interesi.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

41. Duke pasur parasysh: (i) deklaratën e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e kontrollit të figurës “Vetting”; (ii) raportin e DSIK-së; (iii) provat shkresore dhe faktet e administruara nga trupi gjykues i Komisionit gjatë hetimit administrativ; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe në seancën dëgjimore,

Trupi gjykues në lidhje me kontaktin e papërshtatshëm deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e plotësuar, të nënshkruar dhe të dorëzuar në DSIK për kontrollin e figurës, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, arsyeton se

Gjatë hetimit administrativ Komisioni nuk konstatoi të dhëna për kontakte të tjera të subjektit të rivlerësimit me këtë shtetas. Subjekti i rivlerësimit nuk ka hetuar apo gjykuar gjatë veprimtarisë së tij, shtetasin F.S. apo ndonjë të afërm të tij.

Sa më sipër, trupi gjykues, bazuar në provat që ka administruar, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, është në kushtet e parashikimeve të pikës 5, të nenit 38, të ligjit nr.84/2016, në lidhje me deklarin e kontaktit të papërshtatshëm në deklaratën për kontrollin e figurës.

Baza ligjore për vlerësimin e figurës

42. Bazuar në analizën e provave dhe fakteve trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- i. subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, në përgjigje të pyetjes të gërmës “g”, të pjesës nr. 5, të “shtojcës 3”, “Të dhëna për sigurinë”, të ligjit nr. 84/2016;
- ii. subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 4, të nenit DH, të Aneksit të Kushtetutës së Shqipërisë, ka bërë deklarime të pasakta duke fshehur fakte të ndodhura deri ditën e deklaramit, sipas nenit 39, të ligjit nr. 84/2016.

Konkluzioni për vlerësimin e figurës

Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Eugen Beçi, nuk ka plotësuar në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës dhe ka fshehur fakte dhe rrethana të ndodhura para dorëzimit, sipas ligjit të këtij formulari. Subjekti i rivlerësimit, z. Eugen Beçi, nuk ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

V. VLERËSIMI I PASURISË

44. ILDKPKI-ja ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit z. Eugen Beçi duke krahasuar: deklaratën e pasurisë “Vetting”; deklaratat e pasurisë në vite dhe dokumentacionin justifikues bankar, jo bankar, etj., të dorëzuar nga vetë subjekti me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës me institucionet publike.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të ILDKPKI-së, kjo e fundit, bazuar në nenin 33 të ligjit, ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë ndër vite;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

VI. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

45. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Hetimi administrativ, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme, të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016, nga ku rezulton se:

46. Për apartament banimi me sip. 169.65 m², me adresë: Rr. “****” ***, k. ***, ap. ***, Tiranë, me nr. pasurie ***, përfituar nëpërmjet kontratës së shkëmbimit nr. ***, datë 17.2.2014, me z. A.R.,.

47. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” si burim krijimi për këtë apartament ka deklaruar:

- apartament me sip. 83.2 m² (blerë me kredi bankare në shumën 5,000,000 lekë marrë në “Raiffeisen Bank”);
- hua në shumën 2,000,000 lekë, marrë vëllait, z. S.B.;
- hua në shumën 2,000,000 lekë, marrë vëllait, G.B.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ për apartamentin me sip. 83.2 m²

48. Për këtë apartament kontrata e sipërmarrjes në datën 3.10.2006 është lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë së ndërtimit “****” sh.a. Sipas kësaj kontrate sipërmarrjeje, subjekti i rivlerësimit do të paguante për këtë apartament vlerën 5,900,000 lekë, si më poshtë:

- 900,000 lekë me nënshkrimin e kontratës;
- 5,000,000 lekë deri më 20 dhjetor 2006.

49. Kontrata e shitjes së këtij apartamenti është lidhur në datën 11.6.2007 ndërmjet subjektit dhe z. M.Z., e në këtë kontratë palët deklarojnë se shuma është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Palët.

Në këtë kontratë shitje të këtij apartamenti, palët nuk i janë referuar kontratës së sipërmarrjes së vitit 2006, të lidhur me shoqërisë së ndërtimit “****” sh.a e as pagesave sipas saj.

50. Ky apartament është financuar nëpërmjet kredisë së butë prej 5.000,000 lekësh në “Raiffeisen Bank”, me kontratë nr. ***, datë 19.12.2006, dhe 200,000 lekë kursime familjare.

51. Nga nxjerrja e llogarisë në lekë në “Raiffeisen Bank” rezulton se pas disbursimit të kredisë subjekti i rivlerësimit ka kryer këto transaksione:

- datë 26.12.2006, disbursuar kredia në shumën 5,000,000 lekë;
- datë 26.12.2006, konvertuar shumën 3,090,000 lekë në euro;

- datë 28.12.2006, kaluar në depozitë bankare *fleksi* shumën 1,700,000 lekë;
- datë 4.1.2007, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr shumën 500,000 lekë;
- datë 5.1.2007, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr shumën 500,000 lekë;
- datë 15.3.2007, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr shumën 500,000 lekë;
- datë 16.3.2007, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr shumën 201,285 lekë.

52. Nga nxjerrja e llogarisë në euro në “Raiffeisen Bank” të subjektit të rivlerësimit rezulton:

- në datën 26.12.2006 është konvertuar shuma 25,000 euro;
- në datën 27.12.2006 është tërhequr *cash* shuma 25,000 euro.

53. Këto transaksione të kryera në llogarinë bankare në emër të subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank” nuk përputhen me parashikimet e kontratës së sipërmarrjes, si dhe nuk vërtetojnë kujt i janë paguar keto shuma të tërhequra *cash*.

54. Në lidhje me dokumentacionin ligjor provues për shlyerjen e vlerës sipas kontratës së sipërmarrjes, nuk ka asnjë dokument financiar (mandatpagesë apo mandatarkëtim) për të dokumentuar shlyerjen e kësaj vlere ndaj shoqërisë ndërtuese “****” sh.a.

55. Në pyetësoin e datës 13.3.2019, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se këto para janë paguar *cash* nga ana e tij, përfaqësuesit të shoqërisë së ndërtimit me të cilin u lidh kontrata e sipërmarrjes.

56. Në deklaratën e interesave private të vitit 2007 subjekti i rivlerësimit deklaroi, ndër të tjera, se ka përfunduar kontrata e shitjes për apartamentin e deklaruar në vitin 2006, regjistruar në ZVRPP me vlerë përfundimtare 5,200,000 lekë.

57. Në deklaratën e interesave private të vitit 2007 subjekti i rivlerësimit deklaroi, edhe prenotim garazhi me vlerë 700,000 lekë brenda vlerës së kontratës së mësipërme me firmën ndërtuese “****”, – sip.10 m² në të njëjtën adresë me apartamentin – 200,000 lekë për këtë garazh paguar nga shoqëria “****”.

58. Z. Eugen Beçi u pyet mbi këtë fakt, për të cilin sqaroi se: *“Çmimi i shitjes ishte përcaktuar në vlerën 5,900,000 lekë, së bashku me porosinë për blerjen e një garazhi, por unë kam paguar vetëm 5,200,000 lekë pasi nuk e bleva garazhin që kisha porositur në fillim. Theksoj se kam paguar vetëm lekë, pasi diferenca prej 700,000 lekë do paguhej nëse do merrja garazhin. Ishte menduar se do merrja edhe një garazh, por realisht nuk e kam blerë atë dhe asnjëherë nuk u kalua në pronësinë time ky aset.”*

59. Nuk ka asnjë deklaram të mëvonshëm ku të jetë parashikuar mosmarrja e këtij garazhi të porositur, apo kthimi i pagesës, deklaruar i paguar nga subjekti i rivlerësimit në DIPV-në e vitit 2007.

60. Në deklaratën vjetore periodike të vitit 2006 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar marrjen e një kredie bankare nga “Tirana Bank” të disbursuar në shumën 600,000 lekë në datën 8.6.2006, për arredim apartamenti.

61. Kjo kredi bankare për arredim apartamenti është disbursuar në datën 8.6.2006 (4 muaj para lidhjes së kontratës së sipërmarrjes) dhe është shlyer në datën 4.7.2006 nëpërmjet depozitimit *cash* të shumës 607,000 lekë.

62. Z. Eugen Beçi, në përgjigje të pyetësorit, i pyetur për shlyerjen e kësaj kredie në datën 26.12.2018, shpjegoi se: *“për të arreduar shtëpinë që kisha marrë në atë vit kishte menduar se do t’i duheshin shumë më tepër para se sa kisha në dispozicion nga kursimet e mia ndër vite dhe për këtë arsye kam marrë këtë kredi. Meqenëse kjo shumë e marrë nuk m’u nevojiti për t’a përdorur, pasi kisha kursim, një shumë të tillë e shleva menjëherë kredinë me qëllim të mos paguaja dy herë interesa, pasi do të merrja dhe kredinë për blerjen e banesës”.*

63. ILDKPKI-ja ,në datën 4.4.2019 vendos në dispozicion të Komisionit procesverbalin e datës 5.9.2016, mbajtur nga inspektori A.N., sipas të cilit, z. Eugen Beçi ka deklaruar dhe ka firmosur në këtë procesverbal se këtë kredi të marrë në vitin 2006 në shumën 600,000 lekë në “Tirana Bank” dhe e ka përdorur për mobilimin e apartamentit.

64. Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit Kushtetutës, subjektit iu kaluar barra e provës me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën për sa më poshtë vijon:

Për hartimin e kontratës së sipërmarrjes dhe çmimi i vendosur në të u përdorën për të aplikuar dhe përfituar kredinë e butë, të përfituar nga “Raiffeisen Bank”;

Për mospërputhje deklarimesh në lidhje në deklaratën “Vetting” me deklarinimet e vitit 2007 për:

- çmimin e blerjes së apartamentit;
- garazhin e porositur edhe pagesën e një pjese të çmimit për të;
- mënyrën e shlyerjes së pagesës për apartamentin;

Për sa duket se, ekziston dyshim i arsyeshëm se ai ka zhvilluar dhe zbatuar veprim fiktiv me qëllim përfitimin e kredisë së butë.

Për sa duket se për kredinë e marrë në “Tirana Bank” subjekti i rivlerësimi ka bërë deklarinim të rremë gjatë hetimit administrativ.

64.1 Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës shpjegoi se Z. M.Z., ishte bashkëpronar në truallin ku u ndërtua pallati. Firma “****” si shoqëri ndërtuese kryente dhe shitjen e apartamenteve në pronësi të pronarëve të truallit, për këtë arsye, u përpilua kontrata me shtetasin M.Z. Ai deklaroi se nuk i ka paguar asnjë lekë detyrime këtij shtetasi, por vetëm firmës “****”. Pra, bëhet fjalë për një marrëdhënie mes firmës ndërtuese “****” dhe pronarëve të truallit ku ndër ta ishte dhe shtetasi M.Z.

Për sa i përket kredisë së marrë në “Tirana Bank” është një keqkuptim, pasi konteksti i përgjigjes lidhet me faktin se ky likuiditet ka pasur si qëllim mobilimin e apartamentit që do blinte. Këtu ka qenë dhe ideja e të dyja përgjigjeve në ILDKPKI dhe në pyetësorët e Komisionit.

Për marrjen e kredisë nuk ka përdorur asnjë kontratë tjetër sipërmarrjeje përveç asaj reale që përputhet me banesën në të cilën u strehua z. M., apartament i cili kaloi në pronësi të tij”.

64.2 Për sa i përket mospërputhjes midis deklarinimeve në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 dhe deklaratës “Vetting” ai shpjegoi se: *“Ka qenë pasaktësi në deklarinime dhe kjo pasaktësi e konstatuar në këto deklarata është qartësuar edhe më përpara deklaratës “Vetting” sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

65. Deklarimi i bërë gjatë hetimit administrativ nga subjekti i rivlerësimit për mospërdorimin e kredisë së marrë nga “Tirana Bank”, bie në kundërshtim me sa ILDKPKI-ja, në datën 4.4.2019 vë në dispozicion procesverbalin e datës 5 shtator 2016, të mbajtur nga inspektori A.N., në të cilin z. Eugen Beçi ka deklaruar e ka firmosur se këtë kredi të marrë në vitin 2006 në shumën 600,000 lekë në “Tirana Bank” e ka përdorur për mobilimin e apartamentit.

66. Referuar pikës 2, të VKM-së nr. 102, datë 5.3.1999, funksionarëve të shtetit, sikundër ishte edhe subjekti i rivlerësimit, ju lindte e drejta të kërkojnë strehim nga shteti kur janë pa banesë.

67. Për përfitimin e kësaj kredie subjekti i rivlerësimit ka hartuar kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 3.10.2006, me shoqërinë e ndërtimit “****” sh.a.

68. Vendimi i Unifikuar me nr. 932, datë 22.6.2000, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë parashikon se: *“Në rastet e fiktivitetit dhe të simulimit, mospërputhjen midis vullnetit dhe shfaqjes së tij e duan vetë palët e veprimt juridik. Veprimi juridik është i simuluar kur kryhet me qëllim që të mbulojë një veprim tjetër juridik, të vlefshëm apo të pavlefshëm, të cilin palët kanë dashur ta kryejnë me të vërtetë dhe që rezulton prej kundërdeklarimit si marrëveshje e fshehtë midis tyre.”*

69. Trupi gjykues bazuar në sa poshtë vijon:

- i. mospërputhjet mes palës shitese në kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 3.10.2006, me palën shitese në kontratën e shitjes së të njëjtit apartament;
- ii. mospërputhjet për çmimin e parashikuar për t’u paguar në kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 3.10.2006, me çmimin e parashikuar për t’u paguar në kontratën e shitjes dhe sa është paguar realisht nga subjekti i rivlerësimit;
- iii. mospërfshirjes në kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 3.10.2006, dhe në kontratën e shitjes të një garazhi deklaruar vetëm në deklaratimet vjetore.
- iv. deklaratimit nga subjekti i rivlerësimit se për garazhin është paguar një shumë monetare e cila nuk deklarohet asnjëherë gjatë deklaratimeve periodike vjetore se është kthyer dhe mungesës së dokumentacionit ligjor e financiar provues që vërteton porositjen apo anulimin e blerjes së tij;
- v. mungesës së dokumentacionit financiar provues që provon pagesat e kryera për këtë pasuri, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 3.10.2006;
- vi. transaksioneve të kryera në llogarinë bankare nga subjekti i rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”, të cilat nuk përputhen me shlyerjen e vlerës sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 3.10.2006;
- vii. faktit të deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit, se ai para hartimit të kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 3.10.2006 kishte filluar të jetonte në këtë apartament prej qershorit të vitit 2006;
- viii. kontratës së kredisë të marrë nga subjekti i rivlerësimit për mobilim banese pranë bankës “Tirana Bank” para hartimit të kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 3.10.2006.

Arrin në përfundimin se kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 3.10.2006, lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë së ndërtimit “****” sh.a., është një veprim “fiktiv” midis palëve.

Shpjegimet e subjektit se firma “****”, si shoqëri ndërtuese, kryente edhe shitjen e apartamenteve në pronësi të pronarëve të truallit, për këtë arsye, u përpilua kontrata me shtetasin M.Z., dhe se ai nuk i ka paguar *asnjë lekë detyrime* këtij shtetasi, por vetëm firmës “****”, duket se nuk përputhen me faktet e rezultuara nga hetimi administrativ dhe nuk mbështeten në asnjë dokumentacion provues ligjor dhe financiar.

70. Kontrata e shitjes së kësaj pasurie të paluajtshme, e lidhur në datën 11.06.2007 ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe z. M.Z., ku palët deklarojnë se shuma është likuiduar jashtë zyrës noteriale nuk referojnë në asnjë moment kontratën e sipërmarrjes së hartuar mes subjektit të rivlerësimit dhe firmës së ndërtimit, apo shlyerjen e pagesave kësaj të fundit, bien ndesh me shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës.

71. Në kushtet kur kontrata e sipërmarrjes u vlerësua si një kontratë fiktive, e cila nuk pa pasur për qëllim krijimin e efekteve midis palëve, por vetëm plotësimin e kushteve për përfitimin e kredisë së butë nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vendosi, pas rezultateve të hetimit që analizën financiare për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme, ta beje duke u bazuar në kontratën e shitjes së vitit 2007.

Analiza financiare për vitin 2007 pas rezultateve të hetimit

Përshkrimi	Viti 2007
Pasuritë	4,556,962
Autoveturë tip "Benz 2400"	- 400,000
Automjet, datë 25.7.2007, nr. ***	500,000
Apartament banimi sip. 90.5 m ²	5,900,000
shtesa/ pakësime e likuiditeteve	-1,443,038
Të ardhurat	1,474,985
Paga, subjekti	1,390,669
Paga, bashkëshortja	84,316
Detyrimet	468,158
Shlyerje e kredisë bankare, "Raiffeisen Bank"	-136,392
Hua, O.C.,	604,550
Shpenzimet	1,437,217
Humbje nga shitja e automjetit	250,000
Interesat e kredisë të marrë në "Raiffeisen Bank" sh.a.	148,135
Shpenzime jetike	696,288
Shpenzime shëndetësore	241,820
Shkollimi i biri, V.B., kolegji "****"	48,000
Udhëtime jashtë vendit sipas sistemit <i>TIMS</i>	52,974
Rezultati financiar	-4,051,036

72. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit në shpjegimet e barrës së provës, se në analizën financiare të vitit 2007 për shpenzimet e kryera prej tij për pagesën e shkollës të djalit, V.B., referuar deklaratës noteriale nr. ***, datë 14.6.2019, të bërë nga prindërit e bashkëshortes, ku ata shpjegojnë se kanë financuar shkollimin e nipërve të tyre, V., dhe D.B., dhe ky fakt duhet të merret në konsideratë në analizën financiare.

73. Trupi gjykues arsyeton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 nuk ka deklaruar se është financuar nga prindërit e bashkëshortes për shkollimin e djalit në kolegjin "****". Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit të datës 16.10.2018, ka deklaruar se prindërit e bashkëshortes kanë mbuluar shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të tij nga viti 2011 – 2014, në shumën prej 648,000 lekësh.

74. Deklarata noteriale nr. ***, datë 14.6.2019, e bërë nga prindërit e bashkëshortes – në të cilën ata shpjegojnë se kanë financuar shkollimin e nipërve të tyre, V., dhe D.B., – ka vlerë të kufizuar provuese, pasi është bërë pas rezultateve të hetimit dhe nuk përputhet me deklaratimet e vetë subjektit gjatë pyetësorëve.

75. Për sa më sipër, trupi gjykues, bazuar në provat dhe në deklaratimet e subjektit, vendosi që në analizën financiare të vitit 2007, shpenzimet për pagesën e shkollës të djalit, V.B., të llogariten si të kryera nga subjekti i rivlerësimit, z. Eugen Beçi.

76. Trupi gjykues pas analizës financiare se kryer arrin në përfundimin se subjekti rivlerësimit ka qenë në pamundësi financiare në vitin 2007 duke rezultuar me bilanc negativ për këtë vit prej për vlerën – 4,051,036 lekë.

Në lidhje me kontratën e shkëmbimit dhe huan e marrë nga vëllezërit

77. Subjekti i rivlerësimit, z. Eugen Beçi dhe z. A.R., kanë nënshkruar kontratën e shkëmbimit nr. ***, datë 17.2.2014, për shkëmbimin e dy apartamenteve të mëposhtme:

- apartamentit me sip. 82.3 m², rivlerësuar 8,065,400 lekë, pronë e subjektit të rivlerësimit, z. Eugen Beçi,
- apartamentit me sipërfaqe 169.65 m², rivlerësuar 22,902,750 lekë, pronë e z. A. R. .

78. Kontrata e shkëmbimit nr. ***, datë 17.2.2014, nuk parashikon asnjë pagesë monetare që do të kryhet mes palëve për këtë shkëmbim.

79. Në datën 27.8.2014, subjekti dhe z. A. R. hartojnë deklaratën noteriale nr. ***, në të cilën deklarojnë se: z. A. R. do të përfitojë për këtë shkëmbim edhe një vlerë monetare në shumën prej 3,200,000 lekësh, e cila do të shlyhet gradualisht brenda një periudhe 8-vjeçare në shumën 400,000 lekë çdo vit, duke filluar nga viti 2014.

80. I pyetur pse nuk u përfshi kjo shumë në kontratën e shkëmbimit, përmes përgjigjeve të protokolluara me nr. ***, datë 26.12.2018, subjekti i rivlerësimit deklaron: *“Kjo shumë nuk u përfshi në kontratën e shkëmbimit pasi u mendua që kontrata tip e shkëmbimit të mos prekej e të mbahej sipas standardit të saj, duke plotësuar dokumentacion shtesë për kompensimin e shumës që duhet t’i jepja z. A. R., për shkak të diferencës në sipërfaqe të apartamentit që do të përfitoja si rrjedhojë e shkëmbimit”*.

81. Palët një ditë pas nënshkrimit të kontratës së shkëmbimit hartojnë deklaratën e datës 18.2.2014 të panoterizuar dhe pa vërtetim nënshkrimi të palëve për të vërtetuar vullnetin e pavesuar të tyre, ku deklarojnë se: *“...Kanë nënshkruar kontratën e shkëmbimit nr.***, datë 17.2.2014, në ekzekutimin e kësaj kontrate, përveç apartamentit me sip. 82.3 m², të përfutuar nga kontrata e shkëmbimit, z. A. R. do të përfitojë edhe një vlerë monetare në shumën 7,200,000 lekë, nga të cilat 4,000,000 lekë i jepen cash në dorë sot, në datën 18.2.2014, ndërsa shuma tjetër 3,200,000 lekë, do të shlyhet gradualisht brenda një periudhe 8-vjeçare sipas kushteve të deklaruara e të përpiluara në një periudhë të mëvonshme përpara noterit”*.

82. Shuma 4,000,000 lekë i jepen z. A. R. nga huaja që subjekti i rivlerësimit u ka marrë vëllezërve të tij, nuk është parashikuar as në kontratën e shkëmbimit, as në deklaratën noteriale të hartuara mes palëve.

83. Kjo shumë deklarohet vetëm në deklaratën periodike të vitit 2014, ku subjekti i rivlerësimit deklaron: *“Apartament banimi, me sip. 169.65 m², përfutuar nga shkëmbimi i pasurisë së paluajtshme me z. A. R. . Për shkëmbimin e kësaj prone në pronësi të z. A. R. kalon apartamenti me sip. 82.30 m², si dhe shuma prej 7,200,000 lekësh.”*

84. ILDKPKI-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 4.4.2019, vendos në dispozicion të Komisionit procesverbalin mbi shpjegimet e subjektit të datës 5.9.2016, ku ndër të tjera ai deklaron: *“Fillimisht kemi bërë kontratën e shkëmbimit. Duke qenë se të dy apartamentet ishin të rivlerësuar nuk pasqyroam pagesën shtesë që do t’i bëja z. R. për shkak të shkëmbimit”*.

85. Në lidhje me huanë që subjekti i rivlerësimit u ka marrë vëllezërve të tij, ai ka depozituar deklaratë pa datë të z. G. B., e cila nuk është bërë para noterit publik, si dhe nuk vërtetohet nënshkrimi i deklaruesit për të vërtetuar vullnetin e pavesuar të tij, nëpërmjet së cilës deklarohet se z. G. B. ka dhënë hua shumën 2,000,000 lekë, në datën 15.2.2014 subjektit të rivlerësimit. Afati i kthimit: 15 vjet dhe deklaratë pa datë të z. S. B., e cila nuk është bërë para noterit publik, si dhe nuk vërtetohet nënshkrimi i deklaruesit për të vërtetuar vullnetin e pavesuar të tij, nëpërmjet së cilës deklarohet se z. S. B. i ka dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumën 2,000,000 lekë, në datën 15.2.2014. Afati i kthimit: 15 vjet.

86. Sipas shkresës nr. ***, datë 16.11.2018, së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, nga regjistrimet hyrje-dalje në sistemin TIMS rezulton se në datën 15.2.2014, e deklaruar si data e dhënies së huas, z. G. B. dhe z. S. B. nuk kanë qenë në Shqipëri.

87. Subjekti i rivlerësimit, me përgjigjet e protokolluara me nr. *** prot., datë 26.12.2018 në Komision, i bashkëlidh deklaratën noteriale nr. ***, të datës 22.12.2018, sipas së cilës z. G. B. dhe z. S. B., ndër të tjera deklarojnë se deklaratën *e huas e kanë bërë në Greqi dhe ia kanë dërguar vëllait me postë nëpërmjet linjave të transportit.*

88. Subjekti i rivlerësimit, me përgjigjet e protokolluara me nr.*** prot., datë 26.12.2018, mbi hua e marra prej vëllezërve të tij shpjegon: *“Këto hua unë e kam marrë në shtëpinë e babait tim, V. Th. B., në qytetin e Librazhdit, në datën 15.2.2014, me pëlqimin e vëllezërve të mi, S., e G.B., të cilët këto para i kishin sjellë cash në periudha të ndryshme kohore të shtëpia e prindërve, pasi kishin vite që punonin në emigracion në Greqi.”*

89. Mbi mënyrën e marrjes së huas dhe sesi është futur shuma e lekëve në Shqipëri, subjekti sqaron: *“Këto hua i kam marrë cash. Këto para vëllezërit e mi i kanë sjellë në Shqipëri në sasi të ndryshme në gjendje cash, kur kanë udhëtuar për pushime apo për të takuar prindërit në Shqipëri dhe, meqë kanë qenë shuma që nuk e kalonin kufirin e shumës që duhej deklaruar, nuk i kanë deklaruar në kufi kalimin e parave”.*

90. Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën për sa më poshtë vijon:

“Nuk ka asnjë dokument financiar provues për dhënien dhe për kthimin e shumës së marrë hua nga vëllezërit tuaj, si burim për krijimin e kësaj pasurie të deklaruar nga Ju në deklaratën “Vetting”. Keni kryer deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, pasi nuk keni deklaruar saktë huadhënësin, i cili ishte babai Juaj e jo vëllezërit, siç deklaroni në deklaratën “Vetting”. Pagesa e shumës prej 4,000,000 lekësh, dhënë z. A. R., nuk provohet me asnjë dokument provues”.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti ka deklaruar: *“...këto para ia mora borxh vëllezërve të mi me mirëkuptimin e tyre, të pasqyruara në deklaratat të cilat ata i përpiluan në Greqi dhe i dërguan tek unë me linjat e autobusëve. Pas kryerjes së këtyre deklaratave, unë kisha mundësi të merrja paratë, të cilat ishin fizikisht në shtëpinë e babait tim, por asnjëherë nuk kanë qenë të babait tim. Bashkëlidhur, referuar kërkesës suaj, po ju ridërgoj deklaratën noteriale nr. ***, datë 22.12.2018, të dy vëllezërve të mi, S. dhe G. B., ku konfirmojnë çdo deklaratë që kanë bërë në lidhje me këtë hua.”*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

91. Palët i kanë pasur të gjitha mundësitë që të bënin të mundur parashikimin e pageses 4,000,000 lekë z. A. R. nga huaja që subjekti i rivlerësimit u ka marrë vëllezërve të tij, në datën 27.8.2014, në kontratën e shkëmbimit si dhe në deklaratën noteriale nr. ***, në të cilën ata deklaruan vetëm se z. A. R. do të përfitojë vlerën 3,200,000 lekë.

92. Deklarata noteriale nr. ***, datë 24.12.2018, e z. R., e paraqitur si provë nga subjekti i rivlerësimit ka vlerë të kufizuar provuese, pasi është bërë nga një mik i subjektit dhe gjatë hetimit administrativ.

93. Bazuar në dokumentet provuese, të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, si më poshtë:

- vërtetim nr. *** amze, datë 13.1.1998, i Zyrës së Punësimit, Dega Neapoli, për z. G. B., ku vërtetohet qëndrimi i tij në shtetin grek qysh prej vitit 1995;
- kërkesë drejtuar nën/Drejtorisë për të Huajt Selanik, nga z. G. B. (formular zyrtar), ku konfirmohet hyrja në vitin 1995; kërkesa mban datën 9.4.1998 (përkthyer dhe noterizuar);
- librezë sigurimi e të punësuarit me të ardhurat përkatëse për vitin 1998 për z. G. B. (përkthyer dhe noterizuar);

- librezë sigurimi e të punësuarit me të ardhurat përkatëse për vitin 1998 për z. G. B. (përkthyer dhe noterizuar);
- kërkesë-deklaratë e z. S. B. (Instituti i Sigurimeve Shoqërore, dega Evosmos) që provon qëndrimin dhe punën e tij në Selanik, Greqi (përkthyer dhe noterizuar);
- vërtetime të shoqatës “Voskopoja”, Selanik për z. S. B., datë 3.10.2002 (përkthyer dhe noterizuar),

Trupi gjykues arsyeton se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë të ardhurat e ligjshme të vëllezërve të tij në shtetin grek, por ngelet e paprovuar nga subjekti i rivlerësimit mënyra se si janë marrë këto hua.

94. Trupi gjykues arsyeton se deklaratat noteriale nr. ***, datë 22.12.2018, të vëllezërve të subjektit të rivlerësimit, S. dhe G. B., në lidhje me këto hua kanë vlerë të kufizuar provuese, pasi janë bërë gjatë hetimit administrativ. Në kuptim të ligjit, huaja pa interes paraqitet si një marrëdhënie kontraktore detyrimi monetar, sipas së cilës: (i) huadhënësi i jep në pronësi huamarrësit një shumë të hollash; dhe (ii) huamarrësi është i detyruar për t’i kthyer huadhënësit aq të holla, brenda afatit të caktuar në kontratë ose, kur nuk është caktuar afat, me kërkesën e huadhënësit. Kodi Civil, në pjesën e posaçme për kontratën e huas nuk përcakton detyrim për formalizmin e kontratës.

95. Nga ana tjetër, dispozitat urdhëruese ligjore për detyrimet monetare formalizojnë fazën e ekzekutimit të detyrimeve të ndërsjella sipas huas, vendin, datën dhe dëftesën e pagesës.

96. Në kuptim të Kodit Civil, kontrata e huas është një kontratë tipike, joformale, që në rastin konkret në thelb ka ekzekutimin e detyrimeve monetare, ekzekutimi i të cilave, në mungesë të një përcaktimi të ndryshëm kontraktor, formalizohet me një shkresë që i lëshohet dikujt për të vërtetuar se i është marrë diçka/para ose për të vërtetuar se ai ka paguar a ka dhënë diçka/para (dëftesë).

97. Për më tepër, në lidhje me marrjen e kësaj huaje, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ndryshoi deklaram gjatë hetimit administrativ duke deklaruar se këto hua nuk ishin marrë nga vëllezërit e tij, por nga babai i tij.

98. Subjekti i rivlerësimit në referim të sa më sipër nuk paraqiti asnjë dokument financiar provues për dhënien dhe për kthimin e shumave, si burim për krijimin e kësaj pasurie deklaruar në deklaratën “Vetting”.

99. Trupi gjykues arsyeton se subjekti i rivlerësimit i ka pasur të gjitha mundësitë që në deklaratën “Vetting” të shpjegonte sa parashikohej në deklaratën noteriale nr. ***, të datës 22.12.2018, sipas së cilës z. G. B. dhe z. S. B., ndër të tjera deklarojnë: “*Huat i kemi bërë në Greqi dhe ia kemi dërguar vëllait përmes linjave të transportit*”, duke deklaruar se këto hua i ka marrë nga të ardhurat e vëllezërve nëpërmjet babait të tij.

100. Referuar analizës së mësipërme ligjore, trupi gjykues vendosi të mos i marrë në konsideratë huat prej vëllezërve të tij në analizën ekonomike për shkëmbimin e apartamenteve në vitin 2014.

Analiza financiare për vitin 2014 pas rezultateve të hetimit

	Viti 2014
Pasuritë	7,091,860
Shkëmbim ap. me sip. 169.65 m ² , me ap. me sip. 82.3 m ²	7,200,000
Pakësuar likuiditetet	-108,140
Të ardhurat	2,750,511
Pagat, subjekti	2,045,496

Paga, Shkolla e Magjistraturës, subjekti	7,200
Paga, bashkëshortja	577,815
Nga prindërit e bashkëshortes për shkollimin e fëmijëve	120,000
Detyrimet	6,631,780
Shlyerje e kredisë bankare “Raiffeisen Bank”	-168,220
Detyrim ndaj z. A. R., për shkëmbimin e apartamentit	2,800,000
Shpenzimet	2,318,247
Interesat e kredisë së marrë në “Raiffeisen Bank”	116,307
Shpenzime jetike	881,520
Shpenzime për arredimin e shtëpisë	720,000
Shkollim, i biri, V. B., kolegji “****”	60,000
Shkollim, i biri, D.B., kolegji “****”	60,000
Shkollim, i biri, V. B., në Shkollën Teknike “Harry T. Fultz”	60,000
Udhëtime jashtë vendit sipas TIMS-it	420,420
Rezultati financiar	-4,027,816

101. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në vitin 2014, duke rezultuar me bilanc negativ për këtë vit prej -4,027,816 lekësh.

Baza ligjore

102. Bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, Komisioni në lidhje me pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 169.65 m², ndodhur në adresën: Rr. “****”, nr. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë, me nr. pasurie ***, deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting”, arrin në përfundimin se:

- i. subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie, në përputhje me paragrafin 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës;
- ii. bazuar në analizën financiare, subjekti ka mungesë të të ardhurave në vlerën - 4,027,816 lekë, për të justifikuar shkëmbimin e apartamenteve në vitin 2014;
- iii. bazuar në analizën financiare, ka mungesë të të ardhurave në vlerë - **4,051,036** lekë për të justifikuar blerjen e apartamentit në vitin 2007;
- iv. subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë në deklaratën “Vetting”, pasi nuk ka paraqitur si burim për krijimin e kësaj pasurie huan e marrë nga babai i tij.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ për likuiditetet e krijuara

103. Në llogarinë bankare në “Raiffeisen Bank” në vitin 2009 subjekti i rivlerësimit ka shtuar gjendjen e likuiditeteve për shumën 359,042 lekë. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 nuk ka deklaruar shtesë në gjendjen e likuiditeteve në llogari bankare të shumës 359,042 lekë:

104 Subjekti ka deklaruar se ka shtuar gjendjen e likuiditeteve *cash* për shumën prej 300,000 lekësh dhe ka shtuar gjendjen në llogarinë bankare të bashkëshortes në shumën prej 62,853 lekësh.

105. Subjektit iu kalua barra e provës në lidhje me rezultatin negativ financiar për këtë vit.

106. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti ka deklaruar: “Për analizën financiare të vitit 2009 kërkoj heqjen edhe të shpenzimeve për shkollim të djalit tjetër, D.”, duke kërkuar që të mos llogaritet si shpenzim i bërë prej tij shkollimi në vite i dy fëmijëve, V. e D. B., në kolegjin arsimor “****”.

“Për sa i përket dietave të përfshira në analizën financiare të vitit 2009 ,të përfuara nga një seminar 21-ditor në Turqi, theksoj se janë përfshirë aty pasi nuk janë fonde që mbulojnë shpenzimet e transportit apo të akomodimit për atë seminar, pasi këto shpenzime ishin të gjitha të mbuluara nga organizatorët e seminarit. Këto ishin para të kursyera nga ana ime e nuk kishin të bënin me shpenzimet për hoteleri, transport apo ushqim.”

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

107. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar se prindërit e bashkëshortes kanë financuar shkollimin e djalit në kolegjin “****”, ndërsa në përgjigje të pyetësorit, datë 16.10.2018, ka deklaruar se prindërit e bashkëshortes kanë mbuluar shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të tij për periudhën 2011 – 2014 në shumën 648,000 lekë.

108. Trupi gjykues arsyeton se subjekti i rivlerësimit se dietat e përfuara nga udhëtimet jashtë vendit për seminarin në Turqi nuk mund të konsiderohen si të ardhura, sepse ato janë të destinuara për t’u shpenzuar gjatë qëndrimit jashtë vendit.

Analiza financiare për vitin 2009 pas rezultateve të hetimit

Përshkrimi	Viti 2009
Pasuritë	721,896
Shtesë likuiditeteve (në bankë dhe cash)	721,896
Të ardhurat	1,763,107
Paga, subjekti	1,500,618
Paga,bashkëshortja	262,489
Detyrimet	-258,666
Shlyerje e kredisë bankare në “Raiffeisen Bank”	-144,815
Hua, O. C.	-113,851
Shpenzimet	1,068,796
Interesat e kredisë së marrë në “Raiffeisen Bank”	139,712
Shpenzime jetike	688,992
Shpenzime shëndetësore	10,974
Shkollimi, i biri, V. Eugen Beçi, kolegji “****”	108,000
Shkollimi, i biri, D. Eugen Beçi, kolegji “****”	48,000
Udhëtime jashtë vendit sipas TIMS-it	73,119
Rezultati financiar	-286,251

109. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare për vitin 2009, duke rezultuar me bilanc negativ për këtë vit në vlerën prej – 286,251 lekësh.

110. Për pasurinë apartament banimi me sip. 73.5 m², ndodhur në adresën: Lagja nr. ***, p. ***, sh. ***, ap. ***, Librazhd, me nr. pasurie ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***, në bashkëpronësi me prindërit e tij, përfutuar në vitin 1993 nga privatizimi i banesave, me kontratë privatizimi nr. ***, datë 4.8.1998. Vlera e deklaruar: 19,139 lekë. Pjesa takuese: 1/3. Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: nuk deklarohet burim krijimi.

111. Bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuar së bashku, për apartament banimi me sip. 73.5 m², ndodhur në adresën: Lagja nr. ***, p. ***, sh. ***, ap. ***, Librazhd, trupi gjykues në lidhje me pasurinë apartament banimi, ndodhur në adresën: Lagja nr. ***, P. ***, shk. ***, ap. ***, Librazhd, me nr. pasurie ***, z.k. ***, arrin në përfundimin se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar dhe nuk u gjetën shkaqe për hetim të mëtejshëm.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ për pasurinë e personave të tjerë të lidhur

112. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të tij janë mbuluar nga prindërit e bashkëshortes për periudhën 2011 – 2014 në shumën 648,000 lekë. Subjekti, gjatë hetimit administrativ deklaroi gjithashtu se ka jetuar qysh prej shtatorit 2004 deri në qershor 2006 pa qira në shtëpinë e blerë nga prindërit e bashkëshortes.

113. Për sa më sipër prindërit e bashkëshortes u konsideruan si persona të tjerë të lidhur, në kuptim të pikës 14, të nenit 3, sipas të cilit: *“Persona të tjerë të lidhur janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi”*.

114. Komisioni kreu hetim mbi fitimin e pronësisë dhe burimet e ligjshme për blerjen e apartamentit në Tiranë nga prindërit e bashkëshortes, si dhe shitjen e këtij apartamenti dy vjet më vonë prej tyre.

115. Gjatë hetimit administrativ, referuar detyrimit të nenit 32/4, nuk u depozitua dokumentacion ligjor provues i mjaftueshëm për burimin e ligjshëm të krijimit të këtij apartamenti. Prindërit e bashkëshortes për periudhën 2004 – 2006, gjatë së cilës e kanë blerë këtë shtëpi, kanë vazhduar të jetojnë e të punojnë në Vlorë.

116. Trupi gjykues kreu analizën financiare për prindërit e bashkëshortes, L., dhe Sh.L., deri në vitin 2004, vit në të cilin u ble apartamenti i përdorur nga subjekti i rivlerësimit.

117. Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën: *“Duket se z. L. dhe znj. Sh.L., persona të tjerë të lidhur me ju, nga të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ, duket se nuk kanë pasur aftësi paguese për blerjen e apartamentit në Rr. “****”, me vlerën prej 1,900,000 lekësh, duke rezultuar me bilanc negativ në vlerën prej –1,926,156 lekësh.”*

118. Subjekti i rivlerësimit, me shpjegimet me nr. *** prot., datë 17.6.2019, depozitoi dokumentacion ligjor provues për të provuar pronësinë e një banese në qytetin e Poliçanit, Skrapar, nga prindërit e bashkëshortes, privatizuar në vlerën 900 lekë, në vitin 1994, dhe shitur në vlerën e 500,000 lekë në datën 20.12.1999.

119. Subjekti kërkoi të merret në konsideratë se ekonomia e të dyja familjeve ka qenë e përbashkët, sepse kur ai ka qenë me punë në qytetin e Shkodrës, larg familjes, dhe gjatë viteve 2000 – 2001 ka kontribuar dhe se . *“Nga ekonomia e përbashkët e dy familjeve tona z. L. L., ka pasur mundësi të kursejë një sasi prej rreth 1,4 milionë lekësh”*.

120. Trupi gjykues administroi gjithashtu dy vërtetime shitesë të sjella nga subjekti i rivlerësimit: vërtetim page nr. *** prot., datë 17.6.2019, të znj. Sh. L., si dhe vërtetim page nr. *** prot., datë 17.6.2019, të z. L.L.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

121. Trupi gjykues, pasi vlerësoi dhe analizoi dokumentacionin depozituar nga subjekti i rivlerësimit me prapësimet e tij, vendosi që per analizen financiare të marrë në konsideratë:

- të ardhurat e z. L.L., për vitin 2003, për të cilat është paraqitur vërtetim page nr. *** prot., datë 17.6.2019, nga “Baza e Pashalimanit” në shumën 251,978 lekë;
- të ardhurat e znj. Sh.L., e punësuar mësuese, sipas vërtetimit të pagës nr. *** prot., datë 17.6.2019, në shumën 152,314 lekë;

- të ardhurat e familjes, përfituar nga shitja e një banese në qytetin e Poliçanit, Skrapar, më 20.12.1999, në shumën 500,000 lekë, apartament përfituar nga privatizimi;
- të ardhurat e realizuara nga firmat piramidale në shumën 1,351,500 lekë, nga të cilat 451,500 lekë janë interesat e përfituara.

122. Trupi gjykues, pasi vlerësoi dhe analizoi dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit me prapësimet e tij, vlerëson të mos marrë në konsideratë:

- kursimet prej rreth 1,4 milionë lekësh të cilat subjekti i rivlerësimit deklaroi se janë kursyer nga ekonomia e përbashkët e dy familjeve, pasi kjo nuk provohet me asnjë dokumentacion provues ligjor e ngelet vetëm në nivel deklarativ;
- shpenzimet që prindërit e bashkëshortes kanë pasur për vajzat e tyre, I., L., e E.L., në lidhje me largimin e tyre jashtë vendit, dhe shpenzimet e mundshme të kryera për largimin e shkollimin e tyre jashtë vendit.

Analiza financiare e prindërve të bashkëshortes pas rezultateve të hetimit.

Analiza financiare	Para Vitit 2003	Viti 2003	1.01.2004-09.09.2004	Totali
Te ardhurat	3,226,626	482,184	376,785	4,085,595
Pensioni i Sh.L.,	0	77,892	107,848	185,740
Paga e Sh.L., mesuese ne Shkoll 9 vjecare *** Bashkia Vlore	731,174	152,314		883,488
Paga e L.L., ne Baza Ushtarake Pashaliman Vlore	643,952	251,978	268,937	1,164,867
Nga firma Piramidale *** (interesa 451 500 leke)	1,351,500			1,351,500
Shitja e apartamentit ne *** Nr. *** dt.12.06.2019	500,000			500,000
Pasurite	1,100,000	0	1,900,000	3,000,000
Blere apartament Sip. 54 m2	1,100,000			1,100,000
Apartament ne Rr. ***	0		1,900,000	1,900,000
Shpenzimet	1,522,643	281,892	187,928	1,992,463
Shpenzime jetike	1,211,184	281,892	187,928	1,681,004
Humbje nga investimi te shoqeria *** , mbetur detyrim shoqeria	116,279			116,279
Humbje nga investimi ne shoqerine *** mbetur detyrim shoqeria	195,180			195,180
Rezultati financiar	603,984	200,292	-1,711,143	-906,868

123. Trupi gjykues, bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, në provat që disponon dhe në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, në lidhje me pasurinë e personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit arrin në përfundimin se në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të apartamentit në përdorim gjatë periudhës 2004 – 2006 në pronësi të prindërve të bashkëshortes.

Baza ligjore

124. Trupi gjykues, bazuar në provat dhe faktet e analizuara së bashku arrin në përfundimin se:

- i. subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e personit tjetër të lidhur, sipas paragrafit 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës;
- ii. subjekti i rivlerësimit, bazuar në provat që disponon Komisioni dhe në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive dhe të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe sipas parashikimeve të paragrafit 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës;
- iii. shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas paragrafit 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni për vlerësimin e pasurisë

125. Trupi gjykues, arrin në përfundimin se subjekti nuk ka pasur mjete monetare, të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e kryera në vitet 2007, 2009 dhe 2014; subjekti nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së tij dhe është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në posedim ose në përdorim të tij; subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e personit tjetër të lidhur, sipas paragrafit 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, Trupi gjykues arrin në përfundimin subjekti rivlerësimit, z. Eugen Beçi, nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë

VII. KONKLZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, zhvilloi seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se:

(i) Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, bazuar në pikën 2 dhe 4 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës së Shqipërisë, pasi ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të pasaktë dhe jo në përputhje me parashikimet e germës “g” të kreut V “Të dhëna për sigurinë”, si dhe ka fshehur fakte të ndodhura sipas nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

(ii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

(iii) Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe deklarim të rremë në Deklaratën-Vetting, për burimin e krijimit të këtyre pasurive.

(iv) Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe të pasurisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenet 179/b, A, Ç, D, DH, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në pikën 1/c, të nenit 58, dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Eugen Beçi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë për Krime të Rënda.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të trupit gjykues të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 26.06.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Xhensila PINE
Relatore

Roland ILIA
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj